



Project
financed by
European Union

WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION



Црвени крст Србије
Red Cross of Serbia

QASJA NË SHËRBIMET E KUJDESIT AFATGJATË NË MAQEDONINË E VERIUT

*Gjetjet më të rëndësishme të studimit të realizuar në kuadër të projektit trevjeçar
"Forcimi i qëndrueshmërisë së të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara
gjatë COVID-19 dhe fatkeqësive të ardhshme" në rajonin e Ballkanit Perëndimor*

- Çfarë është kujdesi afatgjatë ?
- Korniza ligjore e kujdesit afatgjatë në Maqedoninë e Veriut.
- Kujdesi afatgjatë nga këndvështrimi i vendim-marrësve dhe ofruesve të shërbimeve të kujdesit afatgjatë
- Gjendja shëndetësore dhe nevoja për kujdes afatgjatë në Maqedoninë e Veriut.
- Si ia dalin personat që kanë nevojë për kujdes afatgjatë në Maqedoninë e Veriut?
- A janë të qasshme dhe deri në çfarë mase shërbimet formale të kujdesit afatgjatë në Maqedoninë e Veriut?
- Rëndësia dhe roli i kujdestarëve joformal.

Hulumtimet globale tregojnë se nevoja për kujdes afatgjatë është më e madhe te personat mbi 65 vjeç dhe te personat me aftësi të kufizuara (PAK)¹. Në nivel evropian, pothuajse një e treta e personave mbi 65 vjeç kanë vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, dhe në mesin e tyre ka më shumë gra sesa burra.²

1 Komisioni Evropian, Drejtorja e Përgjithshme për Punësim, Çështje Sociale dhe Përfshirje (2014). Mbrojtja adekuatë sociale për nevojat e kujdesit afatgjatë në një shoqëri në plakje: raport i përgatitur bashkërisht nga Komiteti i Mbrojtjes Sociale dhe Komisioni Evropian, Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, f. 11. <https://data.europa.eu/doi/10.2767/32352>.

2 Komisioni Evropian, Drejtorja e Përgjithshme për Punësim, Çështje Sociale dhe Përfshirje (2021). Raporti i kujdesit afatgjatë: trendët,

Vlerësohet se numri i personave që potencialisht kanë nevojë për kujdes afatgjatë do të rritet nga 30,8 milion në vitin 2019 deri në 38,1 milion në vitin 2050.³

Për të nxjerrë në pah specifikat e funksionimit të sistemit të kujdesit afatgjatë në Ballkanin Perëndimor, Grupi i Nismës për Zhvillim SeConS zhvilloi një studim në kuadër të projektit "Forcimi i qëndrueshmërisë së të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara gjatë COVID-19 dhe fatkeqësive të ardhshme", që duhet të jetë bazë për formulimin e rekomandimeve se si të rriten kapacitetet e ofruesve të shërbimeve dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC), si të përmirësohen politikat publike dhe si të rriten përfitimet financiare – në mënyrë që të sigurohet qasje më e mirë në shërbimet e kujdesit afatgjatë për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara në rrethana të rregullta, veçanërisht në rast të situatave të jashtëzakonshme si pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19.

Ky studim është një përpjekje pioniere. Ai është kryer duke përdorur të njëjtën metodologji për Bosnjë dhe Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë, Kosovën* dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa analiza për secilin vend bazohet në të dhënat e mbledhura përmes analizës nga tavolina (shqyrtimi i rregulloreve dhe të dhënave të disponueshme publikisht), anketës sasiore (në Maqedoninë e Veriut me një mostër prej 650

sfidat dhe mundësitë në një shoqëri në moshim, Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, f. 28, <https://data.europa.eu/doi/10.2767/677726>.

3 Po aty.

personash mbi 65 vjeç dhe PAK të moshës nga 18 deri në 64 vjeç, ku në mesin e atyre mbi 65 vjeç kishte 53,5% gra dhe 46,5% burra, dhe në mesin e PAK 52% gra dhe 48% burra) dhe *anketës cilësore*

(intervistë e thellë me ofruesit e shërbimeve, përfaqësuesit e institucioneve dhe përdoruesit e shërbimeve të kujdesit afatgjatë).

ÇFARË ËSHTË KUJDESI AFATGJATË?

Metodologjia e zbatuar në këtë studim bazohet në përkufizimin e kujdesit afatgjatë të propozuar nga Komisioni Evropian dhe Komiteti i Mbrojtjes Sociale (KMS) në vitin 2014:

Kujdesi afatgjatë është një grup i shërbimeve dhe formave të mbështetjes për personat të cilët për shkak të dobësisë mendore dhe/ose fizike dhe/ose paaftësisë për një periudhë të gjatë kohore varen nga mbështetja në kryerjen e aktiviteteve të përditshme dhe/ose kanë nevojë për ndihmë të zgjatur mjekësore.

Aktivitetet e përditshme që kërkojnë mbështetje mund të përfshijnë:

- aktivitetet e kujdesit personal që personi duhet të kryejë çdo ditë (aktivitete të jetës së përditshme si larja, veshja, ushqimi, ngritja nga krevati ose karrigia, shkuarja në shtrat, lëvizja përreth, përdorimi i tualetit, kontrolli i funksionit të fshikëzës dhe zorrëve), ose
- aktivitetet që kanë të bëjnë me jetesën e pavarur (si përgatitja e ushqimeve, menaxhimi i parave, blerja e gjërave ushqimore, punët e shtëpisë dhe përdorimi i telefonit).

KORNIZA LIGJORE E KUJDESIT AFATGJATË NË MAQEDONINË E VERIUT

Në Maqedoninë e Veriut nuk ekziston një sistem i vetëm i kujdesit afatgjatë, por nevojat që mbuloohen nga ky term plotësohen përmes veprimtarisë së kujdesit **social** dhe **shëndetësor**, përkatësisht përmes shërbimeve që synojnë nevojat e qytetarëve të cilët nuk mund të kryejnë në mënyrë të pavarur aktivitetet e përditshme, përfitimeve materiale që kontribuojnë në realizimin e atyre nevojave dhe mbështetjes për anëtarët e familjes që kujdesen për të afërmit e tyre. Korniza normative e sistemit shëndetësor dhe e sistemit të mbrojtjes sociale i orienton këto dy sisteme në bashkëpunim të ndërsjellë, ndërsa Ligji për Mbrojtjen Sociale⁴ ofron mundësinë

e krijimit të institucioneve sociale dhe shëndetësore që do t'u përgjigjen nevojave të përdoruesve në rrethana specifike sociale dhe shëndetësore.

"Kujdesi afatgjatë" si term i veçantë në **sistemin e mbrojtjes sociale** në Maqedoninë e Veriut nuk ekziston, por i referohet shërbimeve që synojnë personat të cilët kanë nevojë për mbështetje në kryerjen e aktiviteteve ditore për shkak të kapaciteteve të reduktuara funksionale. Në këtë kuptim, përfituesit e mbrojtjes sociale janë personat mbi 65 vjeç dhe PAK, ndërsa shërbimet e mbrojtjes sociale përfshijnë kujdesin rezidencial (akomodimin në një institucion dhe akomodimin familjar) dhe shërbimet e ofruara në komunitet (kujdes ditor, ndihmë

4 "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 104/2019.



dhe kujdes në shtëpi dhe jetesa me mbështetje dhe të kujdesit familjar).

Qeveria përcakton rrjetin e institucioneve publike për mbrojtjen sociale. Komuna, komunat në territorin e Maqedonisë, Qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit sigurojnë zbatimin e mbrojtjes sociale. Shërbimet e mirëqenies sociale të financuara nga fondet publike ofrohen nga organizata që i përkasin një rrjeti ofruesish të licencuar të shërbimeve të mbrojtjes sociale. Ministria përgjegjëse për politikën sociale formon një rrjet të ofruesve të autorizuar të mbrojtjes sociale që përbëhet nga institucionet publike të mbrojtjes sociale dhe ofruesish të tjerë të shërbimeve (shoqata dhe persona të tjerë juridik vendas dhe të huaj) të cilët kanë lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve sociale me autoritetet kompetente, si dhe me persona privat të licencuar për veprimtarinë e mbrojtjes sociale si veprimtari profesionale me kontratë të lidhur me një qendër për punë sociale.

Ofrimi i shërbimeve të caktuara të mbrojtjes sociale (akomodimi në institucion dhe akomodimi me një familje tjetër) mund të financohet nga fondet e përfutuesit dhe të personave që janë të detyruar ta mbështesin atë në përputhje me rregulloret⁵ nëse ka mundësi për këtë dhe nëse këto fonde nuk janë të mjaftueshme – shpenzimet mbulohen nga fondet publike. PAK që përdorin shërbimet e akomodimit në një institucion ose akomodim familjar mund të përjashtohen plotësisht ose pjesërisht nga pagesa për shërbimin nëse kanë vetëm të ardhura personale dhe nëse nuk ka persona që janë të detyruar t'i mbështesin. Cilësia e shërbimeve të mbrojtjes so-

5 Neni 2, Rregullorja për llojin dhe shtrirjen e shërbimeve të mbrojtjes sociale që paguhet nga përdoruesit dhe lartësia e pjesëmarrjes në shpenzimet e përdoruesit dhe të personave që janë të detyruar ta mbështesin atë në bazë të rregulloreve të tjera, "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 177/2018.

cialë dhe respektimi i rregulloreve monitorohet nga mbikëqyrja inspektuese e ministrisë kompetente, ndërsa mbikëqyrjen e punës profesionale të institucioneve të mbrojtjes sociale dhe ofruesve të tjerë të këtyre shërbimeve e kryen Enti për Veprimtari Sociale. Procedurën për shfrytëzimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale e kryen Qendra për Punë Sociale.

Rregulloret në Maqedoninë e Veriut e përkufizojnë **kujdesin shëndetësor** si një aktivitet i cili përveç trajtimit të pacientit synon edhe pavarësinë në kryerjen e funksioneve themelore jetësore, si dhe kujdesin për të sëmurët, rehabilitimin dhe kujdesin paliativ.⁶ Aktivitetet e kujdesit shëndetësor që synojnë kujdesin afatgjatë kryhen në formën e trajtimit shtëpiak dhe spitalor dhe përfshijnë trajtimin mjekësor të pacientëve brenda institucioneve për mbrojtje sociale dhe kujdes paliativ.⁷ Në përputhje me këtë, institucioneve në fushën e mbrojtjes sociale u mundësohet zbatimimi i masave të caktuara të aktiviteteve shëndetësore në nivel primar për personat e vendosur në ato institucione.⁸ Kujdesi paliativ përkufizohet si ndihma aktive për pacientët me sëmundje të pashërueshme të avancuar dhe ndihma për të afërmit e tyre gjatë sëmundjes dhe periudhës kur ata janë në zi.⁹

Institucioni kryesor shëndetësor në Maqedoninë e Veriut që bashkon disiplina të ndryshme në fushën e kujdesit shëndetësor dhe social është Instituti Gerontologjik, i cili është specifik në atë që integron kujdesin

6 Neni 8, Ligji për Mbrojtje Sociale, "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 104/2019.

7 Neni 26, Ligji për Mbrojtje Shëndetësore, Tekste të pastruara të redaktuara, ([LIGJI PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE \(zdravstvo.gov.mk\)](#))

8 Neni 96, Ligji për Mbrojtje Shëndetësore, Tekste të pastruara të redaktuara, ([LIGJI PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE \(zdravstvo.gov.mk\)](#))

9 Neni 10, Ligji për Mbrojtje Shëndetësore, Tekste të pastruara të redaktuara, ([LIGJI PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE \(zdravstvo.gov.mk\)](#))

geriatrik, afatgjatë dhe paliativ. Duke marrë parasysh kapacitetet e pamjaftueshme të kujdesit paliativ dhe kërkesën në rritje, në vitin 2005 u hap një institucion për kujdesin paliativ në Manastir, qytetin e dytë më të madh në vend. Nisma të tilla u shfaqën edhe në nivel lokal, me hapjen e shërbimit të parë komunal të kujdesit paliativ në komunën Sveti Nikole, si pjesë e iniciativës për bashkëpunim ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe organeve të vetëqeverisjes lokale. Kjo nismë u fillua si pjesë e planit operacional për masa aktive punësimi në vitin 2012 dhe mund të shërbejë si model për adresimin e nevojave të kujdesit paliativ në komunitet. Kjo lloj iniciative ekziston edhe në organizata tjera si Zafir Saito nga Kumanova, Kiro Krsteski Platnik nga Prilepi dhe të gjitha institucionet private për mbrojtje sociale (shtëpi private).

Mbështetja financiare e dedikuar për realizimin e kujdesit afatgjatë në Maqedoninë e Veriut realizohet përmes kompensimit për ndihmë dhe përkujdesje të një personi tjetër. Të drejtën e kësaj ndihme e kanë personat mbi 26 vjeç me aftësi të kufizuara intelektuale të moderuar, të rëndë ose të thellë, personat me aftësi të kufizuara fizike të rënda dhe më të rënda, personat plotësisht të verbër, si dhe personat me ndryshime të përhershme në gjendjen e tyre shëndetësore.¹⁰ E drejta e kompensimit realizohet në bazë të gjendjes shëndetësore të përdoruesit, e cila përcaktohet nga komisioni përkatës mjekësor. Ky kompensim nuk kushtëzohet nga niveli i të ardhurave të tjera të përdoruesit dhe realizohet pa verifikim paraprak të gjendjes financiare, ndërsa shuma përcaktohet në varësi të shtrirjes së nevojës.

KUJDESI AFATGJATË NGA KËNDVËSHTRIMI I VENDIMMARRËSVE DHE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Në kuadër të pjesës cilësore të hulumtimit, përfaqësuesi i vetëqeverisjes lokale si një nga problemet më të theksuara potencoi mungesën e informacionit të nevojshëm për të hartuar një program dhe plan veprimi në fushën e shërbimeve të kujdesit afatgjatë në nivel komunal; të dhënat statistiko-re për numrin e të moshuarve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit afatgjatë, dhe llojin e kujdesit dhe ndihmën që kanë nevojë. Si problem shtesë ai vuri në dukje numrin e pamjaftueshëm të vendeve në shtëpitë e të moshuarve në komunën e tij, por theksoi edhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat që ofrojnë shërbime të kujdesit afatgjatë.

Ofruesit e shërbimeve të sektorit joqeveritar që u intervistuan theksojnë se nevojat për kuj-

des afatgjatë i tejkalojnë kapacitetet e tyre dhe një nga arsytet e përmendura është ikja e punonjësve drejt vendeve të BE-së për të ardhura më të larta, ndërsa ata që mbeten përballen me stres, djegie psikike profesionale në punë dhe motivim të ulët.

Ofruesit e shërbimeve të sektorit shtetëror, nga ana tjetër, përmendin mungesën e personelit mjekësor të trajnuar të specializuar për të punuar me PAK dhe pajtohen se ka mungesë të kapaciteteve akomoduese në shtëpitë e të moshuarve. Ka edhe një përfaqësim të pabarabartë territorial të shërbimeve, ndaj edhe banorë të qyteteve të tjera presin strehim në shtëpi në disa institucione.

GJENDJA SHËNDETËSORE DHE NEVOJA PËR KUJDES AFATGJATË NË MAQEDONINË E VERIUT

Sipas të dhënave të hulumtimit sasior të kryer, në Maqedoninë e Veriut, një e katërta e të anketuarve (25,6%) **të moshës mbi 65 vjeç** kanë nevojë për kujdes afatgjatë për shkak të vështirësive në funksionim. Burrat dhe gratë përfaqësohen pothuajse në mënyrë të barabartë mes tyre, ku gratë shprehin një nevojë më të madhe për mbështetje në akti-

vitete të tilla si ushtrimet terapeutike dhe vizita te mjeku, ndërsa burrat në aktivitete të tilla si mirëmbajtja e shtëpisë dhe përgatitja e ushqimit.


Nevoja për mbështetje rritet me moshën – njerëzit mbi 75 vjeç shprehin një nevojë më të madhe

¹⁰ Neni 48, Ligji për Mbrojtje Sociale, "Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 104/2019.

për mbështetje sesa ata të moshës 65 deri në 74 vjeç, përveç kur bëhet fjalë për aktivitete të tilla si përcjellja e shëndetit, konsumi i ushqimit, psi-

koterapia dhe përdorimi i teknologjive digjitale (në këto aktivitete, me vite nuk rritet nevoja për mbështetje).

Grafiku: Përqindja e personave që kanë nevojë për kujdes afatgjatë për shkak të vështirësive të mëdha në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, %




Burimi: SeConS, Anketa mbi qasjen në shërbimet e kujdesit afatgjatë në Maqedoninë e Veriut, 2021

Arsyeja më e shpeshtë e vështirësive në kryerjen e aktiviteteve të përditshme janë vështirësitë e mëdha që ndërlidhen me lëvizjen (15,6%) dhe shikimin (9,3%). Ata kanë nevojë më së shumti për mbështe-

tje në riparimet në banesë, pagesën e faturave dhe në aktivitetet që kanë të bëjnë me shëndetin e tyre (vizita te mjeku dhe përcjellja e vazhdueshme e shëndetit të tyre).

Grafiku: Përqindja e të moshuarve që shprehën nevojën për mbështetje në kryerjen e aktiviteteve, sipas llojit të aktivitetit, %



Burimi: SeConS, Anketa mbi qasjen në shërbimet e kujdesit afatgjatë në Maqedoninë e Veriut, 2021

Në mesin e të anketuarve me aftësi të kufizuara të moshës 18 deri në 64 vjeç, rreth 64% kanë nevojë për kujdes afatgjatë për shkak të vështirësive të mëdha në kryerjen e aktiviteteve të përditshme, më së shpeshti të shkaktuara nga vështirësitë në lëvizje (36%), pastaj vështirësitë që lidhen me shikimin

(17%), vështirësitë me përqendrim dhe memorie (12%), vështirësitë në komunikim (8%), vështirësitë në dëgjim (5%) dhe vështirësitë për shkak të sëmundjeve kronike (3%). Ky grup i të anketuarve më së shpeshti ka nevojë për mbështetje kur shkojnë në mjeku, kur bëjnë ushtrime terapeutike dhe shëtitje.

SI IA DALIN PERSONAT QË KANË NEVOJË PËR KUJDES AFATGJATË NË MAQEDONINË E VERIUT

Hulumtimi tregoi se për sa i përket plotësimit të nevojave për kujdes afatgjatë në Maqedoninë e Veriut, mbështetja te kujdestarët joformalë është thelbësore. Vetëm 4,3% e të anketuarve kanë thënë se një person me pagesë nga një agjenci shtetërore apo private i ndihmon në aktivitetet për të cilat kanë nevojë për mbështetje, dhe 6,1% e tyre kanë theksuar se nuk kanë mbështetje dhe se ia dalin vetë. Gratë mbështeten pak më shumë se burrat tek anëtarët e familjes që jetojnë jashtë shtetësisë ose te fqinjët dhe përdorin shërbimet e shërbimit të paguar shtetëror pak më shumë, dhe burrat mbështeten pak më shumë tek anëtarët e familjes që jetojnë në të njëjtën familje.

Me moshën (75+), përqindja e atyre që mbështeten tek anëtarët e familjes që jetojnë në familje zvogëlohet, ndërsa rritet përqindja e atyre që mbështeten tek anëtarët e familjes që jetojnë jashtë familjes ose te personat me pagesë nga shërbimi privat apo shtetëror. PAK nën moshën 64 vjeç më shpesh mbështeten në shërbimet e sistemit të kujdesit social dhe shën-

detësor sesa personat mbi 65 vjeç, dhe në të njëjtën kohë, ata janë më shpesh të detyruar t'ia dalin vetë.

Mbështetja te kujdestarët joformalë është tradicionalisht më e theksuar në zonat rurale ndërsa të anketuarit që jetojnë në Shkup dhe qendrat rajonale mbështeten më shumë në shërbimet e paguara të shërbimit shtetëror sesa ata nga qytetet dhe fshatrat më të vogla, dhe më pak duhet t'ia dalin vetë kur plotësojnë nevojat gjë që mund të jetë tregues i disponueshmërisë së shërbimit.

Është interesant fakti se pothuajse një e treta e personave mbi 75 vjeç (29.4%) thonë se mund t'i kryejnë vetë aktivitetet e përditshme, megjithëse shpeshherë nuk ndodh ashtu.

Për shumicën e të anketuarve nga mostra, nevoja për mbështetje gjatë pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 ka mbetur e njëjtë si më parë (61,7%). Megjithatë, 27,1% kanë theksuar se nevoja është rritur gjatë pandemisë, ndërsa 11,2% kanë theksuar se nevoja për mbështetje ka rënë.

A JANË TË DISPONUESHME DHE DERI NË ÇFARË MASE SHËRBIMET FORMALE TË KUJDESIT AFATGJATË NË MAQEDONINË E VERIUT

Brenda sistemit të kujdesit shëndetësor, vetëm 8,8% e të anketuarve kanë përdorur shërbimet e trajtimit në shtëpi dhe shërbimet e patronazhit. Në mesin e tyre, shumica janë të kënaqur me shërbimet, ndërsa arsye për pakënaqësitë e mundshme është se vizitat janë të pamjaftueshme. Gjysma e të anketuarve besojnë se gjatë pandemisë këto shërbime ishin të disponueshme në mënyrë të barabartë.

Sa i përket shërbimeve në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale, shërbimet e qendrave ditore janë përdorur

nga vetëm 12 të anketuar në këtë hulumtim ndërsa ndihma në shtëpi vetëm nga 21 të anketuar. Përveç faktit që shërbimi i qendrës ditore është ndërprerë gjatë pandemisë, të anketuarit janë përgjithësisht të kënaqur me këtë shërbim. Sa i përket ndihmës në shtëpi, mangësitë kryesore janë kohëzgjatja e pamjaftueshme e mbështetjes gjatë ditës/javës, si dhe çmimi i shërbimeve të ofruesve privatë.

Vetëm 32% e të anketuarve ishin të informuar ose pjesërisht të informuar për shërbimet e akomodimit

familjar dhe arsyt më të shpeshta për të menduar për shërbimet e akomodimit familjar për të moshuarit janë shqetësimi se ata nuk do të jenë në gjendje të kujdesen për veten si më parë, por edhe vetmia, si dhe pamundësia për të kryer aktivitetet e nevojshme rreth shtëpisë.

Në lidhje me **akomodimin rezidencial**, vetëm 33,7% e të anketuarve ishin plotësisht ose pjesërisht të informuar për të dhe ata do të vendosnin ta përdorin këtë shërbim kryesisht për shkak të disponueshmërisë së kujdesit të vazhdueshëm shëndetësor.

Shërbimet e një **asistenti personal** janë shumë të pakta, ndërsa mangësia kryesore e theksuar nga përdoruesit është koha e kufizuar gjatë ditës së punës. Përdoruesit e këtij shërbimi janë më të kënaqur me ofruesit privatë sesa me ofruesit shtetëror dhe si arsye kryesore përmendin personelin pamjaf-tueshëm të trajnuar dhe profesional dhe mungesën e terapisë fizike si pjesë e këtij shërbimi me të dy grupet e ofruesve. Gjatë pandemisë, shërbimi është ofruar në të njëjtin shtrirje, por me respektim të masave kufizuese.




RËNDËSIA DHE ROLI I KUJDESTARËVE JOFORMAL

Shtyllat e kujdesit joformal në Maqedoninë e Veriut janë fëmijët dhe bashkëshortët, në mbështetjen e të cilëve burrat dhe gratë mbështeten në mënyrë të barabartë, ndërsa në fëmijët mbështetjen më shumë personat mbi 75 vjeç sesa personat e moshës 65 deri në 74 vjeç. Të anke-

tuarit theksojnë se mbështetja e bashkëshortëve është më e rëndësishmja. Kur bëhet fjalë për PAK nën moshën 65 vjeç, 35,8% e tyre mbështeten te bashkëshortët e tyre, një e treta te prindërit (32,1%), 18,9% te fëmijët dhe 7,5% te vëllezërit apo motrat e tyre.

Grafiku: Ofruesit e kujdesit joformal



Burimi: SeConS, Anketa mbi qasjen në shërbimet e kujdesit afatgjatë në Maqedoninë e Veriut, 2021

Pjesa dërrmuese (85,9%) e të anketuarve që mbështeten në përkrahjen e kujdestarëve joformalë në kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme nuk marrin asnjë kompensim nga shteti për kujdesin dhe ndihmën e dikujt tjetër. Vetëm 8,1% e kujdestarëve marrin mbështetje profesionale nga organizata dhe institucione përkatëse si institucionet e mbrojtjes sociale, kujdesit shëndetësor apo organizatat humanitare.

Kujdestarët joformal janë me shëndet të mirë në 90,8% të rasteve dhe nuk kanë nevojë për mbështe-

tje, siç perceptohet nga përdoruesit. Ata që theksojnë se kujdestarët e tyre kanë nevojë për mbështetje shtesë, si arsye kryesore për këtë theksojnë sëmundjet kronike (70,6%), ndonjë lloj paaftësie (17,6%) dhe në 11,8% janë arsye të tjera.

Shërbimet e pushimit, të cilat u mundësojnë kujdestarëve joformal të bëjnë një pushim të shkurtër, janë përdorur nga vetëm 2,4% e të anketuarve të të cilët u identifikua nevoja për kujdes afatgjatë.



Ky dokument është rezultat i një studimi të realizuar në kuadër të projektit trevjeçar “Forcimi i qëndrueshmërisë së të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara gjatë COVID-19 dhe fatkeqësive të ardhshme”.

Projekti koordinohet nga Kryqi i Kuq i Serbisë dhe mbështetet nga Bashkimi Evropian, Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Kryqi i Kuq Austriak.

Është iniciuar në fund të vitit 2020 dhe lidh partnerë nga shoqëria civile e Serbisë, Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, si dhe një rrjet të madh të shoqërisë civile që përfaqëson personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara në nivel të Bashkimit Evropian.*

Konsorciumi i projektit përfshin: Kryqin e Kuq të Serbisë, Kryqin e Kuq Austriak, Kryqin e Kuq Shqiptar, Shoqatën Shqiptare të Geriatriisë dhe Gerontologjisë, Shoqërinë e Kryqit të Kuq të Bosnjës dhe Hercegovinës, Shoqatën për Ndihmë dhe Zhvillim HAJDE, Kryqin e Kuq të Malit të Zi, Unionin e të Verbërve të Malit të Zi, Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqatën Humaniteti, Caritas Kosova, Organizatën Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara të Serbisë, Grupin e Nismës për Zhvillim SeConS, Platformën e Evropës AGE dhe Forumin Evropian për Aftësi të Kufizuara.

Ky publikim është punuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.